

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar në bazë të njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Vintergejt Internacional SE (Wintergate International SE), me seli të regjistruar në rr. Evropska nr. 2758/11, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, e dorëzuar përmes Shoqërisë së Avokatëve Georgi Dimitrov, Avokatë nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 14.07.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga Vintergejt Internacional SE (Wintergate International SE), me seli të regjistruar në rr. Evropska nr. 2758/11, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke mbi Titankoin Internacional a.s. (Titancoin International a.s.), me seli në rr. Evropska nr. 2758/11, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 14.06.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Vintergejt Internacional SE (Wintergate International SE), me seli të regjistruar në rr. Evropska nr. 2758/11, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, me të cilën Vintergejt Internacional SE do të fitoj kontroll të pavarur mbi Titankoin Internacional a.s. (Titancoin International a.s.), me seli në rr. Evropska nr. 2758/11, Dejvice, 160 00 Pragë 6, Republika Çeke, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Vintergejt Internacional SE është një shoqëri për qëllime të veçanta nën kontrollin indirekt të Rokavej Kapital SE (Rockaway Capital SE), shoqëri mëmë e Grupit Rokavej, bazuar në Çeki. Aktivitetet e biznesit të Grupit Rokavej përfshijnë kryesisht tregtinë elektronike, agjencitë e udhëtimit online, teknologjitë financiare, botimin e librave dhe mediave të tjera, kapitalin sipërmarrës dhe investimet në zhvillimin e pasurive të paluajtshme.

Grupi Rokavej është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes Grupit Gjirafa (Gjirafa Group), mbi të cilin ushtron kontroll të përbashkët. Grupi Gjirafa operon një mjet kërkimi në gjuhën shqipe, platformë video/lajme, platformë marketingu online dhe platformë për tregtinë elektronike e fokusuar në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Grupi Gjirafa ka një shoqëri të varur në Maqedoninë e Veriut, Shoqërinë për tregti dhe shërbime elektronike JIRAFI SHPKNJP Shkup, Autostrada e Adriatikut nr. 86 Shkup, e cila është aktive në fushën e shitjes me pakicë online.

Titankoin Internacional a.s. nuk ushtron në mënyrë të pavarur veprimtari afariste, zotëron 100% të aksioneve në VIVANTIS a.s. (VIVANTIS a.s.), shoqëri aksionare çeke, me seli në ul. Shkollni namesti nr. 14, 537 01 Hrudim, Republika Çeke. Vivantis a.s. operon me dyqane të ndryshme elektronike që janë aktive kryesisht në Republikën Çeke, Sllovaki, Rumani, Hungari, Austri dhe Itali, dhe janë të fokusuara kryesisht në kozmetikë, parfume, modë, orë dhe bizhuteri, elektronikë (veçanërisht elektronikë të konsumit dhe pajisje të vogla shtëpiake) dhe produkte të lehonisë

Titankoin Internacional a.s. nuk ka shoqëri të varur në Maqedoninë e Veriut dhe as nuk është e pranishme në tregun e Maqedonisë së Veriut në ndonjë mënyrë tjetër.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски